



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË  
GRAMSH

Nr. 341 / 2 prot

Gramsh, më 30 / 01 / 2023

Vendim

Nr. 01 , dt. 30 .01.2023

Për

**Miratimin e kërkesave për përfitimin e granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese për disa familje në nevojë, bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh**

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të datës 30 .01.2023, pasi mori në shqyrtim relacionin e drejtorisë së Shërbimeve me Sipërmarrje , Transporteve, Strehimi dhe Emergjencave Civile “Për miratimin e kërkesave për përfitimin e granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese për disa familje në nevojë, bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh”, në mbështetje të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, në VKM nr.454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, në Udhëzimin e MFE, nr.31, dt.18.11.2019, “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2;

**V e n d o s i:**

- I. Të miratohet kërkesa për 12 familje në nevojë për të përfituar nga grantet konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese për disa familje në nevojë, bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh. Të miratohet lista me emrat e familjeve përfituese si më poshtë :
  1. Safet Zylal Mema ,banues në Fshat Gramsh Njësia Administrative Pishaj ,familje e përbërë nga 3 anëtarë.Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë ato të ndihmës ekonomike.
  2. Ali Arif Kotorri ,banues në fshatin Kotorr ,Njësia Administrative Pishaj,familje e përbërë nga 2 anëtarë të cilët janë pensionistë dhe jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.
  3. Xhevair Sali Mema banues në Fshat -Gramsh,Njësia Administrative Pishaj,familje e përbërë nga 2 anëtarë të cilët janë pensionistë dhe jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.
  4. Xhezo Xhafer Dollenga ,banues në fshatin Plepas ,Njësia Administrative Tunjë , familje e përbërë nga 6 anëtarë.Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë ato të ndihmës ekonomike dhe gjendja në të cilën jetojnë është shumë e vështirë.Shtëpia e tyre është gati në shembje.
  5. Azbi Kadri Cani banues në fshatin Prrenjas ,Njësia Administrative Tunjë , familje e përbërë nga 4 anëtarë.Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë ato të ndihmës ekonomike.

6. Lytfti Dajlan Kokonozi banues në fshatin Dumberas ,Njësia Administrative Kushovë , familje e përbëre nga 3 anëtarë.Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë ato të ndihmës ekonomike.
  7. Agim Selim Zani banues në fshatin Dumberas, Njësia Administrative Kushovë, familje e përbëre nga 3 anëtarë.Të ardhurat e vetme të kësaj familje janë ato të ndihmës ekonomike.Ka në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar.
  8. Veli Shahini banues ne fshatin Bersnik Poshtë,Njësia Administrative Kodovjat ,familje e përbëre nga 2 anëtarë, të cilët jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.
  9. Bato Zhupani banues ne fshatin Kullollas,Njësia Administrative Skenderbegas,familje e përbëre nga 2 anëtarë, të cilët jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.
  10. Artimon Leka banues ne fshatin Siman ,Njësia Administrative Skenderbegas,familje e përbëre nga 6 anëtarë, të cilët jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike
  11. Nurihan Cohodari banuese ne fshatin Skenderbegas,Njësia Administrative Skenderbegas,familje e përbëre nga 7 anëtarë, të cilët jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.
  12. Feim Baci banues ne fshatin Bersnik Poshtë,Njësia Administrative Kodovjat ,familje e përbëre nga 5 anëtarë, të cilët jetojnë në kushte të vështira ekonomike.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë,drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencave civile,drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretari i Këshillit të Bashkisë**  
**Xhulia GJINI**

Konc.Xh.Gjini  
Konf.G.Lena  
Dosja: \_\_\_\_\_  
AFati I ruajtjes: \_\_\_\_\_

**Kryetari i Këshillit të Bashkisë**  
**Greta LENA**

